



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 PRILL 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 17. APRILA 2014. GODINE**

**PRILL - APRIL  
2014**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dhe
7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

## **Dnevni red**

1. Vreme za deklaracije izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne plenarne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Komisioneru Skupštine Republike Kosova za Snagu bezbednosti i Kosovsku policiju,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o popisu poljoprivrede,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Generalnom revizoru i Nacionalnoj revizorskoj kancelariji Republike Kosova, i
6. Imenovanje člana Upravnog odbora Sudskog instituta Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Do të duhej t'ia fillonim me vazhdimin e seancës, por nuk e kemi numrin e duhur për të votuar.

Po fillojmë me seancë të re dhe pas dy pikave të para, nëse i kemi mbi 80 deputetë, fillojmë votimin e pikave të seancës së kaluar.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta. Ata që janë në emër të grupit, të deklarohen më herët. Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

I shtyrë nga zhvillimet politike në verilindje të kontinentit tonë, për ta rritur sigurinë në region dhe për të dhënë leksione në përmasa globale, për ta relativizuar rolin e OKB-së në planetin tonë, e cila përherë e më shumë dhe veçanërisht aktualisht është në ndikimin e mentaliteteve joemancipuese, Bashkimi Evropian dhe NATO-ja duhet t'i zbusin kriteret për anëtarësimin me të drejta të plota të Republikës së Kosovës.

Lidhjet e popullit të Kosovës me sistemin e vlerave të Bashkimit Evropian dhe lidhjet e popullit tonë me parimet dhe synimet e NATO-s janë të njohura botërisht dhe çka do që unë të përsëris nuk del serioze për faktin, sepse unë do të përsëris, do të numëroj diçka që tash ky popull dhe ky opinionioni ynë, por gjithashtu edhe opinionet në BE, gjithashtu edhe në NATO, i kanë të njohura dhe natyrisht i kanë të studiuara nga ekspertët e tyre.

Lidhjet e popullit tonë me vlerat e Bashkimit Evropian janë të gjata, datojnë nga vitet e '70-ta, '80-ta, '90-ta dhe veçanërisht lidhjet e popullit të Kosovës me synimet dhe aspiratat e NATO-s janë të mishëruara dhe të betonuara jashtëzakonisht që nga vitet '98-'99 dhe këndej përherë, deri tani me mbështetjen në teori dhe në praktikë të krijimit të Forcave të Armatosura të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,  
“Vdes 16-vjeçari që aksidentohet në Gërmi”, pastaj “Aksident me fatalitet në kryeqytet”, pastaj “Një i vdekur në aksidentin e Konjuhut”, pastaj “Vdes 21-vjeçarja që u shkel te Mensa e Studentëve”. Këta janë vetëm disa prej titujve të këtij prilli që hasen nëpër portalet tona, e që tregojnë për pasigurinë dhe rrezikun në të cilin gjenden pjesëmarrësit në komunikacion, e posaçërisht këmbësorët nga drejtuesit e pandërgjegjshëm të automjeteve, të cilët madje herë-herë po marrin guximin që të organizojnë dhe të zhvillojnë gara rely jozyrtare nëpër rrugët tona.

Nga veprimet e drejtuesve të pandërgjegjshëm, për të mos thënë gati të çmendur, vetëm gjatë vitit 2013 në Kosovë janë shkakuar afro 20 mijë aksidente, prej të cilave afro 5 000 janë përcjellë me lëndime të ndryshme trupore, në të cilat janë lënduar 11 084 persona.

Ç’është më e keqja, si pasojë e këtyre aksidenteve, 154 persona të pafajshëm e kanë humbur jetën, madje kur bëhet krahasimi i të vdekurve në aksidente komunikacioni me pasoja e vepra penale të vrasjeve, atëherë shihet se gjatë vitit 2013, numri i personave të vrarë është shumë më i vogël se sa i të vdekurve në aksidentet e trafikut.

Konkretisht, në vitin që e kemi lënë pas në Kosovë kishte 39 persona të vrarë, numër ky që është për afro katër herë më i vogël se sa numri i të vdekurve në trafikun rrugor.

Për pasoja të tmerrshme të vozitësve të shfrenuar flasin edhe statistikat e vendit tonë, sipas të cilave në Kosovë prej vitit 2002 deri në vitin 2011 kanë vdekur 1 430 persona dhe janë lënduar me dhjetëra-mijëra të tjerë.

Nuk ka dyshim se ndër faktorët kyçë të shfrenimit të këtyre, sidomos të vozitësve të rinj dhe adoleshentë, është edhe politika joadekuate ndëshkimore, sepse sikur Policia, ashtu edhe gjykatat tona gjatë shqyrtimit dhe ndëshkimit të veprimeve të kundërligjshme të vozitësve të pandërgjegjshëm, si duket, po i harrojnë pasojat e veprimeve të këtyre shkelësve të ligjit, si duket po i harrojnë lotët dhe dhimbjet e familjarëve të viktimave, andaj këta kryerës që po mbështjellin me zi dhe mort shumë familje kosovare po i ndëshkojnë me dënime shumë të buta, e herë-herë edhe me dënime me kusht.

Andaj, nga ky Kuvend, për hir të familjeve që përjetuan vuajtje dhe dhimbje shpirtërore nga humbja e më të dashurve të tyre, në emër të sigurisë së popullatës së Kosovës, kërkoj nga organet e drejtësisë që tani e tutje ndaj shkelësve të tillë të ligjit t’i shqiptojnë dënimet më të rënda ligjore të mundshme, ashtu që dënimet e shqiptuara ta kenë jo vetëm karakterin represiv ndaj fajtorëve, por të kenë edhe karakter preventiv ndaj të gjithë kryerësve eventuale të veprimeve të kundërligjshme ndaj sigurisë së trafikut rrugor në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!  
Flas në emër të grupit.

Më 18 maj të vitit 2011, në pikë të ditës dhe në mes të Prishtinës, e ndjera Diana Kastari u vra nga bashkëshorti.

Jemi afro tre vjet pas kësaj vrasjeje dhe në vend që familjarët të informohen në drejtim të kapjes së vrasësit, ata tronditen nga institucionet e Kosovës, me theks të veçantë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe nga Presidenca.

Para disa ditëve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës unanimisht i ka propozuar Presidentes dekretimin për gjyqtarin, i cili nuk ofroi mbrojtje për Dianën, me gjithë faktin që në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, të datës 26 shkurt, thuhet se ka pasur shkelje të së drejtës për jetë dhe shkelje të së drejtës për mjete juridike dhe me gjithë faktin që para se Këshilli Gjyqësor ta bëjë një propozim të tillë, gjyqtari Hamdi Ibrahim, në vlerësimin e tij dhënë Komisionit për Verifikim dhe Vlerësim të Performansës, ka deklaruar se gjyqtari Enver Shabanaj e ka një performansë të dobët.

Kjo më së miri e tregon qasjen e Këshillit Gjyqësor ndaj sistemit dhe përbërësve të tij, pra ndaj gjyqtarëve të pandërgjegjshëm.

Me emërimin e gjyqtarit Enver Shabanaj, Këshilli Gjyqësor u përbetua edhe një herë - jo për ta luftuar krimin dhe për t'ua shqiptuar dënimin merititor kryesve, por u përbetua për pandërgjegjshmëri dhe në mbrojtje të tyre.

Për fat të keq, Presidentja e vendit nuk e mori mundin për refuzimin e një propozimi të tillë. Përkundrazi, pa kurrfarë mëdyshjeje e dekretoi gjyqtarin, i cili ia mohoj Dianës të drejtën në jetë dhe në mbrojtje.

Për këtë më duhet t'i citoj dispozitat sa për t'ua kujtuar këtyre që nuk patën ndjesi apo morale dhe as etike që me këtë propozim dhe dekret ata e shpërfillën edhe Kushtetutën dhe ligjet e vendit, pasi neni 104, paragrafi 4 i Kushtetutës, thotë: “Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale, ose për mosrespektimin e rëndë të detyra”. Pra, për mosrespektimin e rëndë të detyrave.

Atëherë, kur e kujtojmë Këshillin Gjyqësor se në paragrafin 4 të nenit 17 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor thuhet: “Me rastin e emërimit të një kandidati, këshilli, ndërmjet tjerash, merr parasysh kriteret në vijim, aftësinë profesionale dhe performansën”.

Ndërsa Presidentes ia kujtojmë se sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 84, paragrafi 2 thuhet: “Presidenti garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë kushtetutë”, atëherë përse nuk u kujdes që të refuzojë emërimin e një gjyqtari të cilit shkeljen ia vërtetoj edhe Gjykata Kushtetuese.

Andaj, në emër të familjarëve të së ndjerës Diana Kastrati, kërkoj nga Presidentja e vendit që ta rishqyrtojë dekretin dhe të marrë vendim në përputhje me nenin 104, paragrafi 1 i Kushtetutës mbi bazën e drejtësisë, duke e shkarkuar gjyqtarin e dekretuar më parë sipas propozimit të KGJK-së, kështu të paktën, duke u mundur që këtij turpi t'ia zvogëlojnë efektin e shkaktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të grupit, fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Tani sot e kam njëfarë mënyre krejt ndryshe të bëj diçka në Kuvend. Zakonisht pyetjet parlamentare u shtrohen ministrave dhe kryeministrit, po unë po ia bëj një pyetje parlamentare kryetarit sot. Nuk është hiç e zorshme, është krejt e lehtë dhe nuk është diçka kontraverse.

Zoti kryetar, para nja pesë vjetësh e pak më keni pas lutur ta lëshoj sallën e Kuvendit se i kam thënë Qeverisë dhe një ministri specifik 'rrenc'. Tani qysh e dalloj unë këtë farë fjale, që nuk është bash parlamentare, është se nuk është rrenë nëse dikush flet diçka prej padijes, s'di të thotë diçka, nuk është problem. Por, kur e di ç'është e vërteta dhe e thotë të pavërtetën, atëherë është 'rrenc'.

Pyetja ime për kryetarin e Kuvendit, është pyetje parlamentare: A i ke rënë pak pishman edhe a ke ndërruar mendje prej para pesë vjetësh. Faleminderit!

KRYETARI: Bën edhe të bie pishman, por kush gënjen - gënjeshtar është. I kemi ne disa fjalë shqipe, me të cilat mund t'i zbusim pak. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Flas në emër të grupit.

Shqetësimi të cilën dua ta ndaj me deputetët, ka të bëjë me Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Ne të gjithë e dimë se ligjet të cilat i miratojmë, kalon një kohë e shkurtër, dhe pas një apo pas dy vjetëve nga vijnë në plotësim-ndryshim. Derisa ky ligj të cilin e përmenda është miratuar në vitin 2003, dhe i njëjti edhe pas 11 vjetëve, edhe pse ka nevojë urgjente për plotësim-ndryshim nuk na vjen në Kuvend që ta bëjmë të njëjtën gjë.

Më duhet të theksoj se ligji përmban shumë nene diskriminuese dhe zbrazëti juridike. Meqë e kam kohën e kufizuar, atëherë më lejoni të ju përmend vetëm një nen, nenin 6.4, pika c. 2, e cila thotë: "Nëse personi vdes para se t'i bëhet pagesa që i takon, atëherë kjo shumë do t'u bëhet fëmijëve, nëse ka pasur, të personit të vdekur dhe në rastet kur janë më shumë se një, në pjesë të barabarta kjo shumë do të ndahet për secilin djalë". A thua çka ndodh nëse personi ka në familje edhe vajza, edhe djem, vajzave nuk do t'u paguhet, apo nëse ka vetëm vajza? Paramendoni çfarë neni diskriminues?

Çështja të cilën dua ta ndaj më konkretisht është se, me të njëjtin ligj personat me aftësi të kufizuara, personat e shurdhër, janë paguar plot 10 vjet, do të thotë e kanë marrë pensionin mjaft të ulët 60-65 euro dhe tani me rritje, mendoj se është 70 euro. Mirëpo, të njëjtit e kanë marrë me të njëjtin ligj pagesën dhe me të njëjtin ligj, tani pas 10 vjetëve, janë përjashtuar nga skema pensionale. Do të thotë, ligji është shkel, ose më herët, ose tani. Nëse ka pasur zbrazëti juridike, të njëjtat është dashur të plotësohen e të rregullohen dhe të njëjtat është dashur të paguhen.

Vendimi i cili është vënë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është vetëm një rresht. Dhe, është, te ju aftësia e kufizuar, e plotë dhe e përhershme nuk ekziston. Do të thotë, e përhershme nuk ekziston - personat e shurdhër, të cilët kanë lindur të shurdhër, po ekzistua mundësia që t'u kthehet të dëgjuarit. Do të kishte qenë mirë, por fatkeqësisht nuk është kështu.

Andaj, krejt në fund dëshiroj, më mirë të them kërkoj nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, edhe pse në komision i kemi ftuar plot tri herë, ministri nuk na ka ardhur, kanë ardhur përfaqësues të tjerë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Gjithashtu më duhet të tregoj se në Komisionin Profesional, edhe pse Komisioni Mjekësor është i paraparë që të jenë mjekët profesionalë, të njëjtit nuk janë në atë komision. Kjo është plus edhe një shkelje tjetër ligjore.

Prandaj, kërkoj nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që urgjentisht të ndërmarrë hapa që këtë ligj ta plotësojë dhe ta ndryshojë. Mirëpo, jo me pasojat e mospagesës së kësaj kategorie. Pagesa të vazhdojë dhe në ndërkohë të plotësohet dhe të ndryshojë ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Ligjet mund të amendamentohen edhe nga 6 apo më shumë deputetë, mandej edhe nga komisionet. Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit të Kosovës!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe unë do ta ndaj shqetësimin e njëjtë me kolegen Haxhiu, meqë si deputete e këtij Parlamenti do të ndaj shqetësimin e familjes të Diana Kastratit, por që në të njëjtën kohë është shqetësim edhe i shumë nënave, i shumë grave dhe i shumë vajzave dhe i shumë familjeve kosovare, të cilat janë ndier të fyera nga dekretimi i një gjyqtari, që Gjykata Kushtetuese e bën përgjegjës për mos ofrim të mbrojtjes së jetës së të ndjerës Diana Kastrati.

Për më tepër, të nderuar kolegë deputetë, jemi ne deputetët e këtij Parlamenti të cilët njëzëri e kemi përshëndetur vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe po ashtu kemi kërkuar masa ndaj zyrtarëve të Gjyqësorit, të cilët nuk e zbatuan ligjin dhe Kushtetutën dhe të jemi të thirrur për ta mbrojtur Kushtetutën dhe për ta respektuar ligjin, pa dashur të kuptohet kjo si ndërhyrje në drejtësi, apo presion në gjykatat, konsideroj se edhe në këtë rast, edhe në rast se ky dekret ka bazë ligjore, mesazhi që përçon jo vetëm te gjysma e popullatës, që jemi gra, por edhe te shumë familje kosovare, është johuman dhe jociwilizues për një shtet demokratik, i cili po synon integrimin në Bashkimin Evropian.

Besueshmëria në Gjyqësor rritet vetëm atëherë kur ky institucion i forcon mekanizmat ligjorë për t'i ofruar mbrojtje secilin qytetar, duke mos e zbehur kështu imazhin dhe besueshmërinë e qytetarëve të Kosovës në sistemin e drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën. Mirë! Deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Flas në emër të grupit.

Shumica e të rinjve e kryejnë shkollimin e mesëm dhe studimet dhe pastaj konkurrojnë në ndonjë vend pune që të mund të punësohen dhe ta kenë një ekzistencë, të krijojnë familje apo ta mbajnë familjen në qoftë se e kanë krijuar, por shumica prej tyre as që mund të ëndërrojnë të punësohen, përpos disave që kanë ndonjë të njohur dhe e realizojnë këtë.

Kryeministri vazhdimisht po premtom rritje të pagave të arsimit, të shëndetësisë, të pensionistëve e tjerë, ulje të shpenzimeve të studentëve. Kjo është shumë mirë në qoftë se mund të realizohet, por kjo popullatë do të ishte shumë e kënaqur dhe e lumtur po qe se kryeministri dhe kjo Qeveri do të mund të hapnin vende të reja pune dhe t'i punësonin të rinjtë, të cilët për shkak të sigurimit të ekzistencës ia mësyjnë Perëndimit, ku kanë mundësi të mëdha të punësimit dhe kushte shumë më të mira të jetës.

Për shkak të këtyre problemeve, më tepër se 200 shqiptarë mbahen nëpër burgjet e Hungarisë, shumica të rinj, familjarë, e ndër ta edhe fëmijë, të cilët janë kapur duke hyrë ilegalisht me destinacionin vendet e Perëndimit. Po qe se do t'i lexonit letrat e tyre, do të kishit kuptuar se çfarë torturash, si psikologjike, ashtu edhe fizike ushtrojnë gardianët e burgjeve ndaj tyre.

Unë po pyes: Çka ka bërë Qeveria, e sidomos ministri i Punëve të Jashtme për këta njerëz që së paku ta kenë një trajtim njerëzor? Përgjigjen mund ta jap unë vetë - asgjë.

Prej vitit 2008, kur kryeministri ka premtuar se Kosova shumë shpejt do të jetë pjesë e vizave shengen, e sot jemi në vitin 2014 dhe nuk ka asgjë nga ky premtim, i cili ka mbetur vetëm në letër. Bile, sipas disa eurodeputeteve të Parlamentit Evropian, kjo nuk mund të ndodhë së paku edhe 3 vjet. Kjo është pasojë e moskryerjes së obligimeve të Kosovës ndaj Bashkimit Evropian.

Unë e ngre çështjen dhe kërkoj nga kjo Qeveri dhe nga ministri i Punëve të Jashtme që urgjentisht, sa më shpejt të ndërmarrë hapa që këta njerëz, të cilët mbahen nëpër burgjet e Hungarisë, më shumë se 200, ta kenë një trajtim të njerëzishëm dhe të ndërmarrë hapa në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës të Kosovës,

Të hënën, më 14 prill të këtij muaji, gazeta prestigjioze britanike 'The Guardian' e publikoi një artikull, që raportonte për punësimin e ish-ambasadorit të Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Kristofer Dell, në korporatën 'Behtel' të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe në të njëjtin artikull i ngiste dyshimet për rolin që ai e ka pasur veçanërisht në kontratën e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe konsorciumit 'Behtel&Enka' për ndërtimin e autostradës këtu në Kosovë.

Ky raportim, ky artikull natyrisht që shkaktoi me të drejtë edhe një debat publik dhe reagim publik në Kosovë për shkak të kësaj kontrate, por do të kisha thënë që kjo është në prej atyre rasteve që mund të cilësohet shumë lehtë si një e ditur e paditur. Pra, diçka që e kemi ditur, por që nuk e kemi ditur që e dimë. Dhe, në këtë drejtim konsideroj se u dëshmuar edhe një herë ajo që e thoshte Lëvizja “Vetëvendosje” prej vitit 2011, me të publikuar kontratën, për dyshimet e shumta në këtë kontratë dhe mënyra se si është arritur ajo, dhe veçanërisht për efektin edhe financiar, edhe politik, që kjo kontratë do ta ketë në Kosovë.

Pra, ju e dini që kontrata tashmë është përmbushur, është përmbyllur, pagesat janë bërë, ka kushtuar diku afro 834 milionë euro sipas raportit të ‘HIR Internacional’, pra të mbikëqyrësit. I tërë projekti i autostradës, i cili ka dalë të jetë më i shkurtër sesa i paramenduari, por shumë më i shtrenjtë sesa i paramenduari.

Ato vërejtje që ne i kemi ngritur për kontratën në vitin 2011 janë dëshmuar në përmbylljen e saj. Pra, nuk ka qenë çmimi as ai që e ka thënë kryeministri edhe këtu në Kuvend se do të jetë afro 700 milionë dhe nuk ishte çmimi as ai që ishte paramenduar, ose projektuar në kontratë, që ka qenë diku 659 milionë. Pra, çmimi i kontratës ka qenë gjithsej 834 milionë për diku 72 kilometra autostradë, në të cilën kompania ‘Behtel’ e ka shfrytëzuar mundësinë maksimale të rritjes të çmimit për secilin segment deri në 20%-shin e lejuar me kontratë.

Pra, një projekt jashtëzakonisht i shtrenjtë, jo vetëm për Buxhetin e Kosovës, por një projekt jashtëzakonisht i shtrenjtë, duke pasur parasysh terrenin dhe cilësinë e kësaj rruge.

Por, çështja që e bënë edhe më të ngutshme nga raportimi i ‘The Guardian’ dhe edhe nga ky debat tash ndërkombëtar që po zhvillohet për këtë çështje, është ta dimë se cili ka qenë roli i këtij ambasadori në nënshkrimin e kësaj kontrate. Pra, i bëj ftesë nga kjo foltore edhe kryeministrit, si kryeministër i kësaj Qeverie, që të tregojë se çfarë ka qenë roli dhe çka e detyroi Qeverinë e Kosovës që ta nënshkruajë një kontratë të tillë, e cila po del të jetë shumë e dëmshme për Kosovën dhe po ashtu...

*(Ndërrprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Në emër të grupit? Vazhdoje, pra!

VISAR YMERI: ...po ashtu, i bëj ftesë edhe Ambasadës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës këtu, por edhe Stej Departamentit që të merren më seriozisht me këtë punë dhe të na tregojë se çfarë ka qenë roli i zotit Dell në këtë kontratë dhe përgjithësisht në Kosovë, sepse e dimë që ndërhyrjet e tij në politikën në Kosovë ka qenë të shumta.

Pra, nëse ai ka pasur rol me nënshkrimin kësaj kontrate nga pozicioni zyrtar i ambasadorit të vendit, atëherë ne duhet ta dimë se në çfarë baze dhe si e ka bërë këtë punë. Të mos harrojmë se i njëjti person është përgjegjës edhe për zgjedhjen e ky presidentëve këtu në Kosovë, njëri prej të cilëve është rrëzuar pastaj nga Gjykata Kushtetuese, pra edhe

Behgjet Pacolli, i zgjedhur president, është raportuar në media, është parë shumë qartë se ka qenë drejtpërdrejt me ndërhyrjen e Kristofer Dellit, dhe pastaj të gjithë e dimë që edhe zonja Jahjaga, presidentja aktuale, është zgjedhur drejtpërdrejt me ndërhyrjen e këtij personi, i cili tash po del që ka qenë i përfshirë edhe në çështje tjera jo edhe ligjore, edhe jo formale të nënshkrimit të marrëveshjeve e kontratave financiare ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe korporatave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, veç të dy e keni kërkuar fjalën në emër të grupit. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministri nuk është këtu, por është një numër i ministrave, ndoshta na tregojnë. Në fillim të vitit 2008, kjo Qeveri pati ardhur në pushtet me një premtim megaloman, që çështja e energjisë elektrike do të zgjidhet në mandatin e parë të tyre. Tash janë në fund të mandatit të dytë, ndërkaq Kosova po vazhdon të jetë në terr, përderisa prej mandatit të parë deri në këtë ditë, nëpërmjet veprimeve të kësaj Qeverie, gjysma e Korporatës Energjetike të Kosovës, rrjedhimisht Distribucioni, është falur për 23 milionë euro, me një garanci që ky çmim tepër i lirë po ndodh me qëllim të ngritjes të cilësisë dhe furnizimit të rregullt me energji elektrike të qytetarëve tanë. Do të thotë, është thënë 23 milionë, po e pranojmë që është lirë, por shërbimet të jenë të cilësisë së lartë dhe qytetarët do të përfitojnë. Po shihet se kjo ka qenë një e pavërtetë e madhe e radhës dhe po shihet që prapa këtij motivi kanë qenë interesat personale, e jo interesat e qytetarit.

Prej vitit 2008 deri më sot janë harxhuar 400 milionë euro, 200 për import dhe 200 kredi. Do të thotë përveç faljes së KEC-it për 23 milionë, qytetarëve të Kosovës kjo Qeveri ua ka marrë edhe 400 milionë shtesë, të cilat është dashur të investohen në sektorë të tjerë dhe sot jemi në borxhe, sot jemi pa energji elektrike, sot e paguajmë energjinë më të shtrenjtë në rajon dhe e kemi falur KEC-in për 23 milionë euro. Prandaj, po dua ta pyes njërin prej ministrave këtu, pasi nuk është kryeministri, çfarë kanë për të na thënë pas këtyre vendimeve kaq të dëmshme dhe pas shkatërrimit të sistemit energjetik në vend? Faleminderit!

KRYETARI: Këto janë deklarime jashtë rendit të ditës. Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala predsedniče!

Kolege poslanici,

Poštovani mediji,

Uvaženi građani opštine Prizrena,

Ovaj parlament je usvojio Ustav o pravima svih zajednica, gde decidivno stoji da se sve zajednice tretiraju podjednako. Isto pravo zastupanja na lokalnom i Republičkom nivou, to pravo imamo i mi Bošnjaci. To pravo nam garantuje Ustav, odnosno Zakon o lokalnoj samoupravi, gde stoji da druga zajednica u odnosu na ukupan broj stanovnika uzima potpredsednika opštine za zajednice, što u Prizrenskoj opštini do sada nije bilo, već se to mesto uvek ustupalo Turskoj zajednici, odnosno samo jednoj političkoj partiji KDTP-u, koja drži i mesto zamenika predsednika Skupštine.

Kao predsednica Nove demokratske stranke i predstavnik Bošnjaka, zahtevam da se poštuje Ustav Republike Kosovo, kao i da na lokalnom nivou svima bude jasno, počev od predsednika Ramadana Muje i Kujtima Gaši, da Ustav moraju da sprovede, jer ćemo se u suprotnom obratiti Ustavnom sudu.

Mi Bošnjačka zajednica nećemo prihvatiti bilo koju vrstu pritisaka u ovom momentu, kada je dobijanje potpredsednika opštine Prizren od nacionalnog interesa, pa makar to bila i Turska ambasada, i Turski KFOR, ili predstavnici Islamske zajednice, jer mi smo jedna suverena država sa svojim Ustavom i zakonima, i svako unutrašnje mešanje je neopravdano.

Ovo je veliko poniženje za Bošnjake, koji su u posleratnom periodu dali veliki doprinos u svim sferama kosovskog sistema. Ramadan Muja i svi ostali, većinski i nevećinski politički subjekti, jednom za sva vremena trebaju znati i prihvatiti da Bošnjaci nisu predizborno sredstvo za njihove pobeđe i zloupotrebe, već su važan i odlučujući politički faktor u prizrenskoj opštini, odnosno Bošnjaka zajednica je Ustavnotvorna kategorija, i kao takva ima zakonsko pravo na svoju političku zastupljenost u lokalnoj samoupravi, i za to pravo ćemo se izboriti.

Ne smemo dozvoliti da se u Prizrenu sruši zajedništvo i zajednički život svih naroda koji predstavljaju model tolerancije i suživota, a da politički lideri rade protiv toga sa odlukama koje narušavaju ugled međuetničkog grada i dovode do etničkih podela. Zahvaljujem!

KRYETARI: Është shpenzuar koha për deklarime jashtë rendit të ditës. Fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti Shaip Muja, pyetje për ministrin Agani.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Zoti ministër Agani,

Unë desha të interesohem lidhur me fondin për sëmundjet e leukemisë së fëmijëve, i cili është alokuar në vlerë prej 5 milionë eurosh dhe dua të njoftohem se si është përgatitur dinamika e implementimit të këtyre mjeteve, qoftë nga planifikimi i resurseve humane, qoftë edhe nga planifikimi i pajisjeve mjekësore laboratorike, të cilat janë shumë të nevojshme për sëmundje të cilat sot kaplojnë mediet tona dhe të cilat në njëfarë forme po paraqesin një turp mbi pamundësinë që ne t'i shërojmë fëmijët me këto sëmundje në Republikën e Kosovës.

Meqenëse, ne e dimë që ka të arritura të mira, mirëpo me këto 5 milionë euro, mendoj që sa ju e keni përgatitur, do të kishim një figurë më të qartë edhe para publikut, por edhe para atyre që edhe neve na drejtohen për ndihmë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Shëndetësisë, menjëherë pas nxjerrjes së vendimeve përkatëse të Qeverisë së Kosovës, nr. 03177 dhe 17181, të datave 14 mars dhe 12 prill 2014, i ka filluar procedurat e nevojshme për implementimin e këtyre vendimeve në funksion kryekëput të trajtimit adekuat të fëmijëve me leukemi, me kancer dhe sëmundje të ngjashme, pra sëmundje të rënda të fëmijëve, të cilat kanë kosto të lartë dhe për të cilat në Republikën e Kosovës nuk ka kushte për trajtim optimal.

Në këtë drejtim janë zhvilluar aktivitetet si në relacion të ngritjes së kapaciteteve të Repartit hemato-onkologjik të Klinikës së Pediatriisë e cila merret kryesisht me trajtimin e këtyre rasteve, po ashtu edhe në anën tjetër me efektivizimin e punës së Bordit për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, procedurave të nevojshme për mobilizimin e këtyre mjeteve në mënyrë optimale.

Në drejtim të parë është nxjerr vendimi i ministrit të Shëndetësisë për zbatimin urgjent të procedurave diagnostiko dhe terapeutike për pacientët në këtë repart, pra për shkurtimin e të gjitha vonesave në diagnostikimin adekuat dhe për zbatimin e procedurave diagnostiko jashtë QKUK-së, në qoftë se për momentin nuk ekzistojnë kushtet adekuate për këtë.

Më tutje, kemi siguruar procedurat që të sigurohen citostatikët e nevojshëm për zbatimin e fazave të para të trajtimit të këtyre rasteve në Klinikën e Pediatriisë. Më tutje do të bëhet bashkëpunimi i ngushtë me organizatat joqeveritare, që ushtrojnë veprimtari në Klinikën e Pediatriisë, për këta fëmijë në mënyrë që të mundësojmë punësimin e shpejtë të kuadrit plotësues, për mbajtjen e kushteve të veçanta të higjienës dhe krijimin e disa kushteve të tjerat teknike për trajtimin e këtyre fëmijëve.

Nëpërmjet drejtorit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, është kërkuar ngritja e kuadrit të nevojshëm për plotësimin e numrit të nevojshëm të infermierëve për trajtim adekuat dhe do të dërgohen katër mjekë specializantë në Klinikën Universitare të Gracit, për specializim njëvjeçar për ngritjen e kapaciteteve profesionale të nevojshme për trajtimin e këtyre fëmijëve në Klinikën e Pediatriisë dhe po ashtu, edhe deri më 1 maj të këtij viti, pra deri në fund të këtij muaji, do të sigurohet edhe kuadri i nevojshëm profesional për atë funksionalizimin e plotë të laboratorit të flousitometrisë.

Në anën tjetër, sa i përket Bordit për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, për momentin në procedurë janë 11 fëmijë, 11 kërkesa dhe 1 kërkesë është paralajmëruar nga Klinika e Pediatriisë se do të bëhet shumë shpejtë. Prej këtyre 11 kërkesave, 5 kërkesa për pesë pagesa..

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Vazhdoja një minutë ministrit!

MINISTRI FERID AGANI: ... janë paguar nga 30 mijë euro si shumë fillestare për fillimin e trajtimit, 1 është aprovuar për pagesë në vlerë prej 30 mijë euro, për 4 raste janë duke u siguruar profakturat nga institucionet shëndetësore, ku prindërit dhe mjekët kanë vendosur që t'i dërgojnë fëmijët për trajtim, 1 rast është duke u realizuar në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimit me Republikën e Turqisë dhe siç thashë, një pacient e kemi që do të aplikojë së shpejti. Por, kjo është gjendja momentale e realizimit të këtij programi.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë? E ka fjalën deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

A keni parë mundësinë, meqë këto format e bashkëpunimit që janë intensifikuar kohët e fundit edhe me Republikën e Shqipërisë, që të shihet njëfarë lloj fuzionomi i disa klinikave specifike, që mbi sasinë e pacientëve dhe volumin që kanë pacientët, të shihet një mundësi të ngritët një qendër kombëtare, qoftë në Tiranë, qoftë në Prishtinë dhe të participohet proporcionalisht në financim për trajtimin e këtyre sëmundjeve dhe të ngritët në nivel profesional. Do të thotë do të kishim të dy shtetet një benifit duke filluar edhe deri tek trajtimi i palcës kockore dhe të trajtimeve më komplekse, sepse shtetet e vogla si ne dhe Shqipëria, të vetme nuk mund të shkojmë, por bashkërisht kishim pasur mundësi për ta ngritur në një nivel shkencor më të lartë edhe me kuadro profesionale edhe me participimin financiar proporcionalisht sa i caktohet.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI FERID AGANI: Po, ju faleminderit!

Më 25 prill, pra nesër një javë, ne do të kemi takim në Prishtinë me delegacionin e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë, që do të kryesohet nga ministri Beqaj.

Dhe, një prej pikave të bisedës do të jetë edhe ngritja e kapaciteteve të përbashkëta profesionale në lëmenj të ndryshëm të ndjeshëm, siç është lëmi i hemato-onkologjisë pediatrike, në veçanti.

Dhe, me siguri se po shkojmë në atë drejtim që t'i bashkojmë resurset profesionale, teknologjike, njerëzore dhe financiare në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve më të mira për problemet, të cilat janë të kësaj natyre jo vetëm për këtë çështje, por edhe në lëmenjtë tjerë të shëndetësisë.

Me këtë rast do ta nënshkruajmë edhe një marrëveshje të bashkëpunimit, në të cilën do të specifikohen në mënyrë konkrete edhe procedurat nëpërmjet të cilave do ta realizojmë këtë synim.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Vazhdojmë. Deputeti Milivoje Stojanoviq, a është këtu? Nuk është. Ka pasur pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

Tani është deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputete, e ke fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në një dokument zyrtar të datës 26 mars 2014, OSBE konsideron Mitrovicën pjesë të Serbisë.

Edhe pse OSBE ka qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës, në asnjë mënyrë nuk mund të shkruajë që Mitrovica gjendet në Serbi.

Në fakt, ky institucion jo vetëm që nuk e ka respektuar mënyrën zyrtare të referimit ndaj Kosovës, por ka shkuar shumë larg duke konsideruar një pjesë të territorit të Kosovës, të njohur nga shumica e vendeve të BE-së si shtet i pavarur, si pjesë të Serbisë.

Në fakt, kjo nuk ka ndodhur vetëm në një dokument, por në disa dokumente, sepse këtë e pash, pasi hulumtova pak më shumë. Prandaj, pyetja ime për ministrin është kjo:

A është në dijeni Ministria e Jashtme për këtë?

A mund të na jepni një përgjigje zyrtare se pse ka ndodhur,

si po prezantohet Kosova në dokumentet e tjera të OSBE-së dhe çfarë po bën Ministria e Jashtme, që të mos shkelet më nëpër dokumentet e organizatave ndërkombëtare sovraniteti i Kosovës?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

Shumë i nderuar, zoti kryetar,

Të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zonja deputete,

Ju falënderoj shumë për pyetjen e bërë.

Dua t'ju them që para se ky lajm të dalë në medie, ne si Ministri e Punëve të Jashtme nuk kemi qenë në dijeni, por të njëjtën kohë kur ky lajm ka qenë në medie, unë nuk kam qenë në Prishtinë, kështu që nuk kam mundur personalisht të bisedoj me ambasadorin e OSBE-së, i cili është edhe shef i këtij misioni në Kosovë.

Ajo çfarë mund të them është që Ministria jonë e Jashtme, e cila e ka një departament që merret me organizata, ka komunikuar direkt me Zyrën e shefit të misionit të OSBE-së dhe neve na është thënë që kjo çfarë ka ndodhur është një gabim teknik.

Ajo çfarë unë dua t'ju siguroj sot juve, është që të martën do të kem takim me ambasadorin e OSBE-së dhe pyetjen që ju ma bëni mua, do ta ngre me seriozitetin më të madh karshi ambasadorit të OSBE-së dhe do t'ju dorëzoj një përgjigje me shkrim dhe të plotë se cili është qëndrimi i OSBE-së.

Përtej kësaj, më lejoni t'ju them që Kosova nuk është anëtare e OSBE-së, por në çdo raport që OSB-ja deri më tash e ka publikuar për Kosovë, para se të botohet një raport i tillë, kemi bërë përpjekje nëpërmjet shteteve anëtare, që janë sponsorë dhe mbështetës të Kosovës, të ndërhyjnë në raporte të tilla.

Dhe, mund t'ju them që shumë shpesh OSBE-ja ka pasur raporte të cilat kanë qenë të dëmshme për Kosovën. Po ashtu, mund t'ju them në këtë seancë, që ka një tendencë nga ana e Serbisë dhe ka një tendencë nga ana e Rusisë, për ta përdorur misionin e OSBE-së në Republikën e Kosovës, për agjendat e tyre, të cilat padyshim që nuk janë favorizuese për shtetin e Kosovës. Dhe, këtë se çfarë po e them në këtë Kuvend e kam ngritur me seriozitetin më të madh dhe me një qasje më përmbajtjesore në të gjitha takimet që kam pasur me OSBE-në.

Qasja jonë ndaj OSBE-së dhe qasja jonë ndaj shumë misionëve, të cilat veprojnë në Kosovë, falë Rezolutës 1244 është që këto misione të cilat kanë gjoja qëndrimin e një statusi neutral karshi Kosovës, t'i lëvizim drejt një statusi pozitiv për Kosovën, që ta pranojnë realitetin e shtetit të Kosovës dhe ta trajtojnë Kosovën si shtet. Po të njëjtën kohë, jam i obliguar t'ju them që ka të tillë të cilët kanë qëndrimin e statusit neutral dhe lëvizin drejt statusit negativ, do të thotë drejt minimumit të elementeve të shtetësisë së Kosovës.

Qëndrimi ynë si Qeveri është që shumica e këtyre...

*(Ndërprerje nga regjia.)*

KRYETARI: Ke pyetje shtesë, deputete?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Ju falënderoj për reagimin pas publikimit të lajmit në lidhje me këtë, nëse është e vërtetë pra, ky reagim. Më vjen mirë që ju e keni marrë seriozisht.

Këshilla ime është që duke qenë se ky megjithatë është një institucion që ka pak probleme në lidhje me këtë, e pohuat edhe ju, por edhe unë vet mund ta deklaroj këtu, sepse kemi pasur edhe një eksperiencë të tillë në një takim të OSBE-së me vendet e ndryshme, pra të gjitha vendet pjesëmarrëse të OSBE-së në Vjenë, kur na është shkaktuar një problem i tillë, sigurisht me kërkesën e Serbisë dhe të Rusisë. Pra, përderisa kemi të bëjmë me një institucion disi problematik, do të duhej që Ministria juaj t'i kushtonte pak më shumë vëmendje mënyrës se si Kosova prezantohet në çfarëdolloj dokumenti zyrtar që ata publikojnë.

Kështu që unë nuk kam pyetje tjetër, por po pres "feedback"-un e takimit tuaj me shefin e OSBE-së në Kosovë. Në asnjë mënyrë nuk mund të lejohet që Mitrovica të paraqitet, është incident shumë i...

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Do të thotë, javën e ardhshme unë do t' ju dërgoj përgjigje me shkrim se çfarë qëndrimi do të ndjekë ambasadori i OSBE-së në takimin që do ta kem. Po, të njëjtën kohë dua t' ju siguroj që deri më tash në të gjitha takimet e mundshme, kur është biseduar për Kosovën, kur është biseduar për Ballkanin, ne si Ministri e Punëve të Jashtme, pas takimit kemi marrë raport të plotë për atë se çfarë është diskutuar për Republikën e Kosovës. Dhe, dua po ashtu, t' ju them, ndoshta jashtë mikrofonit mund t'ju tregoj edhe për dy-tri tendenca të cilat ne i kemi ndaluar në vitin 2011, 2012, të cilat kanë qenë pjesë e raportimit.

Kur unë si ministër i Jashtëm e them para jush që kemi frikë nga përdorimi i OSBE-së si vegël në shërbim të politikës serbe dhe ruse, mendoj që është përtej asaj se çfarë mund të thuhet në foltoren e Kuvendit.

Unë të falënderoj për çështjen që ke ngritur, por dua të siguroj që jam shumë serioz jo vetëm sa i përket OSBE-së, por jam shumë serioz edhe sa i përket UNMIK-ut në Kosovë, meqë shpeshherë misione të tilla synojnë që ta minojnë shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe kam ngritur çdo takim me partnerët tanë, aty ku ne nuk kemi anëtarë.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Nenad Rashiç. Ministri s'është këtu. Deputet, e ke fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!  
Po e lëmë për seancën e radhës pyetjen. Shpresojmë se atëherë ministri do të jetë këtu.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Ministri nuk është këtu. Deputete, mund ta bësh pyetjen.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!  
Meqë pyetja ime parlamentare ka të bëjë me çështjen që unë e kam ngritur në seancën e kaluar, në çështje jashtë rendit të ditës e që ka të bëjë me memorialin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Marinë i cili është mbyllur para dy javëve, është një çështje e ndjeshme, unë pres që ministri të vijë javën e ardhshme dhe do ta bart për seancën e ardhshme pyetjen parlamentare.

KRYETARI: Jemi duke pritur të kthehen deputetët që të vazhdojmë me procesin e votimit.

A i kemi 61 deputetë? Urdhëroni, deputete Nazane Breca, ç'kemi?

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryetar!  
Unë desha vetëm t' ju lus dhe ta ngrit si çështje se unë para disa javëve i kam bërë pyetje ministrit të Punëve të Jashtme, mirëpo deri më tash as përgjigje gojore as përgjigje me shkrim nuk kam marrë nga ai, kështu që në qoftë se ka kohë unë kisha mund për ta përsëritur pyetjen.

KRYETARI: Unë nuk e kam në rend të ditës pyetjen tuaj. Ajo ka shkuar do të thotë dy herë, nëse s'ka përgjigje ajo duhet të përsëritet, botohet në revistën e Kuvendit.

Vazhdojmë. Unë nuk kam këtu të shkruar pyetje tjetër.

Janë 66 deputetë. Votojmë dhe pikën e tretë:

### **3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme**

Pyes, nëse ka vërejtje në procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 3 prill 2014. A ka ndonjë vërejtje? Nëse nuk ka, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 3, 7 dhe 10 prill 2014.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)*

### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës**

Ky projektligj është propozuar nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Qeveria e Kosovës brenda afatit të paracaktuar e ka proceduar mendimin lidhur me këtë projektligj, duke shprehur qëndrimin që projektligji të jetë pjesë e pakos së ndryshimeve dhe plotësimeve.

Ideja për themelimin e komisionarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës duhet të zhvillohet më tutje dhe se ky projektligj përkon përpunim të mëtjetshëm në mënyrë të detajuar, thuhet në mendimin e Qeverisë së Kosovës.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka dhënë rekomandimin për miratim në parim.

E ftoj deputetin Ahmet Isufi, në cilësinë e propozuesit, që ta paraqesë projektligjin.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në kuadër të forcimit të kontrollit civil parlamentar dhe mbikëqyrjes demokratike ndaj institucioneve të sigurisë, e me qëllim të avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të personalit të Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe të Policisë së Kosovës, Komisioni Parlamentar FunkSIONAL për Çështje të Sigurisë i Kuvendit të Kosovës e ka sponsorizuar projektligjin për komisionarin e Kuvendit për këto dy segmente të sigurisë.

Komisioni gjatë tërë kohës së hartimit të projektligjit, mbështetur nga GIZ-i gjerman dhe personalisht nga zoti Rainal Robe, ish-komisionar i Bundestagut Gjerman për Forcat e Armatosura Gjermane, si dhe në angazhimet që ka pasur edhe me DIKAF-in, dhe po

ashtu OSBE-në dhe mekanizma të tjerë, të cilët kanë të bëjnë me sferën e sigurisë, e kanë përkrahur një institucion të tillë.

Gjithashtu, edhe ministrinë përkatëse të linjës i kanë pasur përfaqësuesit e tyre në grupet e punës për hartimin e këtij projektligji.

Tani jemi në kohën kur priten ndryshme në sektorin e sigurisë, e veçanërisht të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës.

Ne në Komisionin FunkSIONAL rekomandojmë që ky projektligj të miratohet në parim, në mënyrë që të përshtatet me amendamentimet konform ndryshimeve të mundshme, të dala nga analiza e rishikimit të sektorit të sigurisë.

Prandaj, si komision konsiderojmë se në leximin e parë mund të kalojë, ndërsa me rastin e ndryshimeve që bëhen me analizën e rishikimit të sektorit të sigurisë mund të bëhen amendamentimet konform këtij ndryshimi të sektorit të sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përsëndetje për ministrin,

Përsëndetje për të nderuarit deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka trajtuar këtë propozim të komisionit dhe ideja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë është shumë e qëlluar se besoj që shteti ynë, përkatësisht Kuvendi do ta ketë një instrument më shumë për të ndikuar në drejtim të rritjes së cilësisë së kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike në Forcën e Sigurisë dhe në Policinë e Kosovës.

Me këtë instrument, ky do të jetë një mundësi që të jetë një adresë e re për t'iu drejtuar të gjithë zyrtarët e Forcës së Sigurisë dhe Policisë për problemet eventuale të cilat nuk mund t'i rregullojnë me procedurat aktuale dhe parimet në institucionet të cilat janë përgjegjëse për kontroll brenda institucioneve. Kështu që faktikisht ky do të jetë një avokat për zyrtarët e këtyre dy strukturave, që do të jetë një derë e qëlluar për t'i zgjidhur problemet e tyre eventuale, apo për të ndikuar në drejtim parandalues për paraqitjen e fenomeneve dhe dukurive negative.

Prandaj, grupi ynë e përkrah këtë projektligj dhe kontributin tonë të mëtejshëm do ta japim gjatë punës në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Institucioni i komisionarit për forcat e armatosura në disa shtete të Perëndimit është i njohur dhe në funksion që prej dy shekujve.

Si komponentë e rëndësishme e qeverisjes demokratike tani është e shtrirë në tërë Evropën dhe më gjerë, e përshtatur me mjedise të ndryshme kulturore, kushtetuese dhe ligjore.

Me këtë ligj synohet të ushtrohen këto funksione nga komisionari:

- Trajtimi i ankesave që dalin nga brenda FSK-së dhe Policisë së Kosovës,
- Ofrimi i rekomandimeve të FSK-ja, Policia e Kosovës, Ekzekutivi dhe Parlamenti,
- Monitorimi i përputhshmërisë së FSK-së dhe Policisë me Ligjin për të drejtat e njeriut dhe me të drejtën humanitare ndërkombëtare,
- Llogaridhënia e FSK-së dhe e Policisë së Kosovës, e të tjera.

Për ilustrim më të mirë, po cek disa nga ankesat me të cilat do të duhej të ballafaqohej komisionari.

Ankesat që kanë të bëjnë me keqtrajtimet e pretenduara, kushtet e këqija të punës, çështjet kontraktore, pushimet dhe pensionet, shqetësimet shëndetësore që dalin nga shërbimi në FSK apo Polici, transferimet, dislokimet dhe shërbimet jashtë vendit, ngritja në grada avancimi, në karrierë e tjera.

I lus deputetët që deri në leximin e dytë të japin mendime dhe vlerësime që institucioni i komisionarit të ketë pavarësi institucionale dhe pavarësi operacionale dhe kjo pavarësi duhet të garantohet me ligj, duke mos e përjashtuar edhe garancinë e dalë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Në fund, dua të theksoj, që megjithëse komisionari nuk e ka fuqinë për ta detyruar zbatimin e rekomandimeve, atij me këtë ligj duhet t'i mundësohet forca e të bindurit për t'i rritur gjatë rekomandimet të zbatohen.

Ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do ta votojmë në parim projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Rexhep Selimi, për “Vetëvendosjen”, e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Siç edhe u tha nga kolegët, të cilët e kanë dhënë kontributin e tyre në draftimin e tij, ky projektligj i draftuar, pra i sponsorizuar nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, e ka bërë një punë shumë të mirë dhe është një shembull shumë i mirë i një pune të mirë të një komisioni të mirë, në këtë rast.

Si i tillë, ky komision e mbulon një fushë shumë të rëndësishme dhe deri më tani të zbrazët në mbrojtjen e të drejtave të ushtarakëve dhe policëve të Kosovës në kryerjen e detyrave të tyre të përditshme.

Unë, duke qenë në krye të grupit punues të draftimit të këtij ligji, dua t'i falënderoj gjithë kolegët e mi që e kanë dhënë kontributin e tyre dhe po ashtu falënderim për të gjithë faktorët tjerë që kanë bërë të mundshme që Kuvendi i Kosovës ta prodhojë një projektligj që nesër do të jetë një ligj, i cili do ta plotësojë një zbrazëtirë deri më tani në fushën e infrastrukturës ligjore në Kosovë.

Pra, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” njëkohësisht, përveç se e mbështet, edhe i kërkon Kuvendit të Kosovës që ta votojë në parim këtë projektligj për të dhënë kontribut ndërmjet leximit të parë dhe të dytë, duke mos harruar se edhe mund të ndodhin ndryshime të pritshme të rolit të FSK-së dhe mendoj që ndryshimet kryesore do të duhej të ndodhnin në momentin kur do të votoheshin apo jo draftet apo amendamentet kushtetuese që kanë të bëjnë me shndërrimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës dhe në përputhje me këtë unë mendoj që ndryshimet më të rëndësishme do të jenë në këtë fushë, nëse jo atëherë mendoj që grupi punues e ka bërë punën më të mirë të mundshme dhe pret kontributin e deputetëve tjerë në amendamente të mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Koalicionit për Kosovën e Re, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrin dhe për deputetët,  
Duke marrë parasysh rëndësinë dhe punën e cila është bërë në Projektligjin për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë dhe Policisë së Kosovës, Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje këtij projektligji dhe besoj që në kohën sa më të shkurtër të vijë edhe në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk kemi të tjerë deputetë që duan të diskutojnë për këtë projektligj. Në sallë i kemi të pranishëm 65 deputetë. Unë kërkoj teknikën dhe deputetët që të votojmë për Projektligjin për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe të Policisë së Kosovës. Votojmë tash!

Me 62 vota për, 1 kundër, ligji kalon në lexim të parë. Pra, Kuvendi e miraton në parim Projektligjin për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe të Policinë e Kosovës.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afat të paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe ta paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë**

E ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.  
Urdhëro, Nait!

NAIT HASANI: Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, më 8.4.2014 e ka shqyrtuar kërkesën dhe Projektligjin e Ministrisë së Bujqësisë për regjistrimin e bujqësisë, që ka ardhur dhe është vetëm plotësim-ndryshim i disa datave të cilat janë kërkuar, kur në vitin e kaluar ka pasur të përfundojë që regjistrimi i bujqësisë, por për shkak të rrethanave të cilat kanë ndodhur me rastin e zgjedhjeve nuk ka mundur të realizohet dhe është kërkuar që datat të ndryshohen dhe të jenë për vitin 2014, prej 1 deri 20 nëntor dhe ligji të përfundojë në muajin shkurt 2015. Prandaj, komisioni është pajtuar dhe i ka sjellë rekomandimet që të miratohen këto data dhe ky ndryshim i Projektligjit për regjistrimin e bujqësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në projektligj janë propozuar gjithsej 5 amendamente nga Komisioni Funkcional. Dua të ma jepni praninë. 63 deputetë janë të pranishëm.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Edhe njëherë ma jepni numrin e të pranishmëve, se po lëvizni shumë. Ta di saktë, sepse në çdo sekondë nuk është i njëjti numër. Tash i kemi 67 të pranishëm. E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e votuara. Votojmë tash!

Me 63 vota për, 3 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë.

Kalojmë në pikën e gjashtë:

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetin Ali Sadriu... Mirë, atëherë pasi nuk është kryetari, nënkryetari Ramiz Lladrovci. Urdhëro!

**RAMIZ LLADROVCI:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 8 prill 2014, e ka aprovuar raportin përfundimtar të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nr. 04/L-236 dhe të njëjtin e ka propozuar që të renditet në seancën plenare për shqyrtim dhe aprovim.

Projektligji numër 04/L-236 ka ardhur në Kuvend më 6 nëntor të vitit 2012. Më 11 nëntor, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar në parim dhe e ka dërguar në seancë për lexim të parë. Më 12 dhe 13 dhjetor 2013 është shqyrtuar në seancë në lexim të parë. Komisioni dhe Grupi punues, sipas Rregullores së Kuvendit, e ka organizuar dëgjimin publik me palët e interesuara, si dhe ka mbajtur takime të shumta, të cilat e kanë dhënë një kontribut të madh në amendamentimin e këtij ligji.

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni me përkushtim ka bërë amendamentimin e këtij projektligji, duke ia siguruar pavarësinë e plotë funksionale dhe organizative në pajtim me standardet ndërkombëtare. Këto standarde janë përcaktuar nga organizata ndërkombëtare e institucioneve të auditimit të përgjithshëm ITSA. ITS-ja në mënyrë të veçantë i referohet Deklaratës së Limas dhe Deklaratës së Meksikos. Ky institucion ndërkombëtar i referohet edhe institucionit të BE-së dhe parashohin se institucioni i Auditorit të Përgjithshëm të jetë funksional, institucional dhe financiarisht i pavarur, t'i raportojë Parlamentit. Në këtë drejtim, komisioni gjatë amendamentimit të këtij projektligji u është referuar praktikave më të mira, shteteve veç e veç dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian, që parashihen në kapitullin 32 të kontrollit financiar.

Kapitulli 32 i legjislacionit të BE-së thotë: Është në kompetencë të shteteve anëtare që nëpërmjet politikave të tyre të brendshme ta rregullojnë Auditorin e Përgjithshëm duke siguruar pavarësinë funksionale dhe organizative. Pra, duke pasur për bazë këto praktika të mira të legjislacionit të BE-së, me këtë projektligj i kemi garantuar pavarësi të plotë Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit në kontrollin e shpenzimeve të buxhetit publik në Republikën e Kosovës. Lidhur me këtë projektligj, me kërkesën e komisionit, është angazhuar edhe një ekspert ndërkombëtar, të cilin e ka angazhuar SIGMA, me financimin e Komisionit Evropian.

Gjatë amendamentimit të projektligjit janë marrë për bazë komentet e ekspertit për të cilat kemi menduar që mund të adaptohen në projektligj. Jo të gjitha komentet kanë mundur të përfshihen, sepse ka pasur edhe propozime për ndryshime kushtetuese, por për këtë ne nuk kemi pasur mandat. Komisioni ka pasur edhe takime të drejtpërdrejta me ekspertin e SIGMA-s dhe në këtë takim ne e kemi pyetur ekspertin nëse auditorët në shtetin e tij janë shërbyes civilë ose jo. Ai na është përgjigjur se po, auditorët janë shërbyes civilë. Dhe, gjatë hulumtimeve që i kemi bërë në të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian, përveç Auditorit të Përgjithshëm, i gjithë stafi tjetër, duke u përfshirë zëvendësauditorin, është staf civil. Gjermania, Suedia dhe vendet tjera edhe Auditorin e Përgjithshëm e kanë staf civil.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, komisioni ka pranuar propozime nga deputeti Goran Marinković dhe nga Shoqata Sindikale e Punëtorëve të GZAP-it. Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për të Drejta dhe Komunitete nuk ka bërë asnjë vërejtje në amendamente. Dhe, kjo na ka lënë për të kuptuar se amendamentet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Komisioni për Buxhet ka propozuar amendament në paragrafin që flet për pagën e Auditorit të Përgjithshëm, duke fshirë atë paragraf. Komisioni për Buxhet e Financa e ka përkrahur dhe e ka inkorporuar në projektligj amendamentin e Komisionit për Buxhet e Financa. Komisioni për Integritet ka proceduar fillimisht dy amendamente, pastaj ka propozuar 5 amendamente.

Komisioni për Integritet Evropian, pasi ka konstatuar saktë, në pikën e parë të rekomandimit, kur thotë: Projektligji numër 04/L-236/1 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Republikës së Kosovës, nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, amendamentet e këtij komisioni i ka vlerësuar të fushës, i ka vlerësuar jashtë fushës së tij dhe i ka votuar në komision me shumicë votash kundër. Amendamentet që i ka propozuar ky komision bien në përgjegjësi të fushës së komisioneve funksionale, si atij për Buxhet e Financa dhe të Komisionit për Legjislaturë.

Prandaj, amendamentet e paraqitura nga Komisioni për Integritet Evropian se sa duhet të jetë paga e Auditorit të Përgjithshëm, sa duhet të jetë paga e stafit të tij apo cilat pozita duhet të ketë kjo zyrë, si duhet të zgjidhen ato, me cilat ligje janë kompetencë e komisioneve funksionale nga të cilat nuk kemi marrë asnjë vërejtje, përveç amendamentit nga Komisioni për Buxhet e Financa, që është përkrahur edhe nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe është inkorporuar në projektligj.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj të votoni projektligjin me amendamente, i cili është në “plotni”, siç thotë profesori Hamiti, në praktikat më të mira të legjislacionit të BE-së. Është me rëndësi të përmendet fakti se dispozitat e këtij ligji parashohin edhe bashkëpunimin e Auditorit të Përgjithshëm

me institucionet zbatuese të ligjit, për të raportuar në rast të shkeljeve të rënda të ligjit të cilat mund të përbëjnë vepër penale.

Pra, projektligji e rregullon organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, ky projektligj e përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, përdorimin dhe qeverisjen e burimeve publike, rrit nivelin e transparencës në funksion të Auditorit të Përgjithshëm.

Prandaj, duke pasur parasysh këto që u thanë më lartë, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ju ftoj ta votoni Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka deputetë që donë të diskutojnë, sepse edhe ashtu jemi në leximin e dytë dhe paraqitjet e mëdha janë qejf me i bë të mëdha, po edhe të panevojshme, mund të themi.

Në Kuvend janë të pranishëm 77 deputetë. Fillojmë me votime të amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti numër 3, kemi dy propozime. I pari është propozimi i Komisionit Funksional, i dyti është propozimi i Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Duhet të votojmë me elektronikë. E nxjerr në votim variantin “a” të Komisionit Funksional. Votojmë tash.

36 janë për, 8 janë kundër, 4 abstenime, nuk ka kuorum për vendimarrje. Domethënë, i pari s’kalon.

E nxjerr në votim variantin “b” të Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahje të Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Me 10 vota kundër, 16 për dhe 8 abstenime, prapë është e njëjta situatë. S’ka kuorum për vendimarrje.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti numër 7 ka dy propozime. Një është nën “a” i Komisionit Funksional dhe nën “b” i dyti i Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

E nxjerr në votim variantin “a” të Komisionit Funksional. Votojmë tash. Janë 80 deputetë të pranishëm

Me 10 vota kundër, 34 për dhe 6 abstenime, që bëjnë... nuk ka kuorum për vendim marrje.

Kalojmë në votimin e variantit “b” të Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahje të Komisionit Funksional. Votojmë tash.

7 janë kundër, 17 janë për, 10 abstenime, po ashtu s’ka kuorum për vendimmarrje.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti numër 14 i ka dy propozime, një të Komisionit Funksional dhe një të Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

E nxjerr në votim së pari amendamentin 14 të Komisionit Funksional. Votojmë tash!

10 janë kundër, 31 janë për, 6 janë abstenime, nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Kalojmë në votimin e amendamentit 14, kërkesë e Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahje të Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Të pranishëm 81 deputetë, po shifrat thonë që 4 janë kundër, 21 janë për, 10 abstenojnë. Nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25, propozim i deputetit Goran Marinković, me përkrahje të Komisionit Funksional.

Pra, votojmë amendamentin 25, të deputetit Marinković, që e përkrah Komisioni Funksional. Votojmë tash!

Në sallë i kemi 83 deputetë.

Dhe kemi 0 kundër, 40 për, 8 abstenime, nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Amendamenti 26 i ka dy propozime: të Komisionit FunkSIONAL dhe 2. të Komisionit për Integritet Evropian.

E hedh në votim amendamentin 26, varianti i Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

I kemi 83 deputetë të pranishëm.

Dhe kemi 7 vota kundër, 32 për, 11 abstenime, nuk ka kuorum për vendimmarrje.

E hedh në votim variantin e të njëjtit nen, pra:

Amendamenti 26, Komisioni për Integritet Evropian, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

6 kundër, 15 për dhe 11 abstenime, nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Dhe tash, i kemi....

*(Ndërprerje)*

Tash një saktësim. Del në votim varianti i Ligjit, me amendamentet që kaluar, por pa amendamentet që nuk kanë kaluar e që janë: amendamenti 3, amendamenti 7, amendamenti 14, amendamenti 25 dhe amendamenti 26.

Me këtë kërkesë, e vë në votim projektligjin.

82 deputetë janë këtu dhe votojmë tash!

Me 0 vota kundër, me 39 për dhe me 6 abstenime, nuk ka kuorum për vendimmarrje për ligjin.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

## **7. Emërimi i një anëtari të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës**

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, kryetari i Këshillit Prokurorial i ka paraqitur Kuvendit propozimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, në bazë të nenit 3.3 dhe Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, ka shqyrtuar propozimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar propozimin dhe ka konstatuar se ka bazë juridike e kushtetuese dhe mund të procedohet për seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Gashi!

Në emër të kryetarëve ose përfaqësuesit ose kryetarët e grupeve parlamentare. PDK, deputeti Bekim Haxhiu. Nuk dëshiron të flasë Haxhiu. Arben Gashi, LDK.

ARBEN GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah rekomandimin e Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Albulena Haxhiu për Grupin e Vetëvendosjes.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrah rekomandimin e Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit Albulena! Për Grupin Parlamentar të Aleancës, Ardian Gjini, shef i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Njëjtë edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet rekomandimin e Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryetarja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re, i jep përkrahje rekomandimit të Komisionit për Legjislacion.

KRYESUESI: Kolegë deputetë, në sallë të Kuvendit janë të pranishëm 79 deputetë. Unë ju ftoj që të votojmë për propozimin e Komisionit për 1 anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota të përgjithshme, domethënë me 69 plus, asnjë kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e emëroi zotin Elez Blakaj anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, me mandat dyvjeçar.

Mirupafshim në mbledhjen e radhës!

*E përgatiti:*  
*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*